

# 4

## Legjislacioni dhe kornizat rregullatore në lidhje me armët e vogla dhe të lehta

### 4.1 Licensimi i eksporteve dhe importeve

**AKTUALISHT**, baza e legjislacionit shqiptar për kontrollet e importit dhe eksportit duket të jetë mjaft e dobët. Shqipëria nuk ka një ligj mbi kontrollet e eksportit ose importit për pajisjet ushtarake dhe mallrat e përdorimit të dyfishtë, duke u mbështetur në një sërë urdhrash, vendimesh dhe rregulloresh ministeriale.

Sipas raportit të Qeverisë Shqiptare paraqitur në Departamentin e Kombeve të Bashkuara për Çështje të Çarmatimit (UNDDA) në 2004,<sup>298</sup> regjimi aktual i kontrollit të eksportit për pajisjet ushtarake është bazuar kryesisht në vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave dhe rregulloret e Qeverisë Shqiptare:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 366, “Mbi themelimin e ndërmarrjes së import-eksportit [në varësi] të Ministrisë së Mbrojtjes” i datës 5 tetor 1991;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 135, “Mbi miratimin e shitjes së armëve dhe municioneve nga Ministria e Mbrojtjes”, i datës 1 maj 1992;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 275, “Mbi administrimin dhe kontrollet e armëve të individëve, personave juridikë dhe enteve ligjore”, i datës 25 qershor 1992;<sup>299</sup>
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 365, “Mbi shkatërrimin ose shitjen e municioneve për të cilat po mbaron ose ka mbaruar periudha e përdorimit dhe mbi shitjen e armatimeve dhe municioneve të tepërta”, dhe amendimet e tij, i datës 6 qershor 1994;<sup>300</sup>
- Rregullorja e Qeverisë Shqiptare Nr. 366, “Mbi shitjen e armatimeve dhe municionit”, i datës 10 gusht 1996;

<sup>298</sup> Burimi: raporti i Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë PoA 2004.

<sup>299</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 389, “Mbi disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave No. 275”, 6 gusht 1993.

<sup>300</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 822, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave No. 365”, 9 dhjetor 1996; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 564, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365”, 22 dhjetor 1997; Vendimi i Këshillit të Ministrave 829, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365”, 30 dhjetor 1998; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 344, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365”, 7 korrik 2000; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 113, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365”, 8 mars 2001; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 17, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365”, 28 janar 2002; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1, “Mbi një amendim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 365”, 10 janar 2003.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 05 “Mbi funksionimin e kompanisë ushtarake të import-eksportit, MEICO, dhe lidhjet e saj me departamentet dhe njësitë e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes”, i datës 08 janar 2002;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 617, “Mbi heqjen e armatimeve, pjesëve të armëve dhe pajisjeve ushtarake nga Forcat e Armatosura për shkatërrimin, cmontimin dhe shitjen e tyre”, dhe rregulloret përkatëse, i datës 4 dhjetor 2002.<sup>301</sup>

Megjithëse paraqitja e Shqipërisë së vitit 2004 në UNDDA deklaroi se autoritetet shqiptare kontrollojnë aktivitetet e brokerimit, nuk ka kritere ligjore që kjo të kryhet aktualisht, sikurse nuk ka kritere ligjore për kontrollimin e tranzitit dhe transfertat e armëve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë. Megjithatë, ritransferimet e pajisjeve ushtarake mbulohen nga Ligji No. 8671 “Mbi komandimin dhe autoritetin e Forcave të Armatosura” i datës 26 tetor 2000, dhe në vitin 2003, u nxor një rregullore e qeverisë që kërkonte që tregtarët e mundshëm të kërkuar të armëve të siguronin çertifikata end-userash për cdo transfertë.<sup>302</sup> Ekipi studimor u informua se Shqipëria përdor si listën e përbashkët të Bashkimit Europian të pajisjeve ushtarake dhe listat e Marrëveshjes së Wassenaar të mallrave me përdorim të dyfishtë, teknologjive dhe municioneve për kontrollimin e armëve, pajisjeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë që janë objekt i kontrolleve të eksportit. Zyrtarët shqiptarë gjithashtu deklaruan se cdo vit në janar, MPJ i siguron kompanisë tregtare shtetërore MEICO një listë të azhurnuar të shteteve embargo të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian. MPJ gjithashtu siguron informacion mbi embargot e reja sapo ato shpallen.<sup>303</sup>

Nga pikëpamja ligjore ka një ndryshim midis importit të armëve të gjuetisë dhe atij të armëve të tjera të zjarrit dhe pajisjeve ushtarake. Sipas nenit 11 të Ligjit No. 7566 “Mbi armët”, “një individ ose person juridik mund të sjellë nga jashtë shtetit një armë gjuetie vetëm kur ata kanë leje nga Ministria e Rendit Publik që të veprojnë në këtë mënyrë”. Praktikisht, kjo do të thotë se kur një individ ka përmbushur kriteret për mbajtjen e një arme gjahu, ata më pas mund të aplikojnë për leje në rajonin lokal të policisë në zonën e tyre, me qëllim që të jenë në gjendje të importojnë një armë gjahu.<sup>304</sup>

Sipas një zyrtari të Ministrisë së Mbrojtjes i ngarkuar për zbatimin e regjimit të kontrollit të eksportit, gjobat për shkelje përfshijnë anulimin e licensës, konfiskimin e dërgesave dhe gjobat që variojnë nga vlera e transfertës deri në njëqind herë të kësaj vlere. Në projektligjin mbi kontrollin e eksportit, ka një propozim për të rritur vlerën e gjobës deri në 150 herë vlerën e transfertës.<sup>305</sup>

Kontrollet e eksportit të armëve në Shqipëri do të përfitonin nga miratimi i një ligji të ri që do të krijonte një kuadër legjislativ gjithëpërfshirës. Një projektligji u përgatit në nëntor të vitit 2004 nga juristë të Ministrisë së Mbrojtjes- megjithëse u siguroa asistencë edhe nga ekspertë ndërkombëtarë. U kërkuan rekomandime nga institucione përkatëse qeveritare si Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Versioni i draftit të “Ligjit për kontrollin mbi aktivitetin e import-eksportit të materialeve ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë dhe teknologjisë” të Shqipërisë, sipas raportit u mbështeten në Ligjin e Ukrainës “Mbi Kontrollin Shtetëror të Transfertave Ndërkombëtare të Mallrave të Destinuara për Qëllime Ushtarake dhe Mallrave me përdorim të dyfishtë” (20 shkurt 2003). Të intervistuarit shqiptarë informuan ekipin kërkimor se ata besonin që legjislacioni ukrainas ishte një model i mirë për Shqipërinë. Sipas tyre, është legjislacioni më gjithëpërfshirës dhe i azhurnuar mbi kontrollin e eksportit.<sup>306</sup> Disa të intervistuar gjithashtu deklaruan se legjislacioni i propozuar do të përfshinte në ligj kërkesat e Kodit të Sjelljes së Bashkimit Europian mbi eksportin e

<sup>301</sup> Rregullorja Nr. 485/1, “Mbi procedurën për ankandin e pajisjeve ushtarake që janë hequr nga përdorimi, siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave No. 617”, 14 tetor 2003; Rregullorja Nr. 495/2, “Mbi procedurën për ankandin e pajisjeve ushtarake që janë hequr nga përdorimi, siç përcaktohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave No. 617”, 21 tetor 2003.

<sup>302</sup> Rregullorja Nr. 9603, “Për përpilimin dhe dokumentimin e aktiviteteve të import-eksportit për pajisjet ushtarake”, 18 shtator 2003.

<sup>303</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 prill 2005.

<sup>304</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit Publik, 25 prill 2005.

<sup>305</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 prill 2005.

<sup>306</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 prill 2005.

armëve dhe Marrëveshjen e Wassenaar-it.<sup>307</sup> Ligji i ri gjithashtu pritej të përfshinte rregullore për tranzitin dhe kontrollet e transfertave, kontrollet mbi brokerimin dhe aktivitetet të ngjashme dhe do të kërkonte që cdo transfertë të shoqërohej nga një certifikatë end-useri dhe verifikime mbi para- ngarkesën para se të mund të nxirrej licenca.

Megjithatë, projektligji nuk kishte kaluar nga parlamenti para se të mbyllej për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005. Megjithëse dikush mund të ankohej për faktin se ndërprerjet e punimeve parlamentare duket të kenë dëmtuar shumë nga përmirësimet që nevojiteshin të bazës legjislative për transfertat e armëve të vogla dhe armatimeve të lehta, ajo gjithashtu siguron një mundësi tjetër për një komision ndërministerial të rishikojë tërësisht nevojat e Shqipërisë në këtë sferë, para përgatitjes së një projektligji të ri që të paraqitet në parlament për rishikim në një të ardhme të afërt.

## 4.2 Korniza Anti-trafik

Sipas Edmond Bahitit, Shefit të Sektorit për Trafikimin e Paligjshëm në Ministrinë e Brendshme, trafikimi nuk ishte mbuluar në kodin penal gjatë periudhës komuniste dhe në njëfarë mënyre nuk ishte krim gjatë atyre kohërave.<sup>308</sup> Megjithatë, ai argumenton se në periudhën post komuniste shqiptarët kanë përfituar nga liria relative për të udhëtuar jashtë shtetit dhe disa shqiptarë kanë krijuar lidhje me grupet e krimit të organizuar në Europë dhe në botë. Që prej vitit 1999, shqiptarët janë bërë edhe objekt, edhe subjekt i trafikimit.

Megjithëse nenet që përcaktojnë bandat e armatosura dhe organizatat kriminale ishin në përmbajtje të Kodit Penal Shqiptar të vitit 1995,<sup>309</sup> vetëm në vitin 2001 ndodhi që nenet mbi “trafikimin e armëve dhe municioneve” (278/a) dhe “Prodhimi dhe armëmbajtja pa leje e armëve të vogla dhe të lehta” (279) u prezantuan në Kodin Penal. Neni 278/1 mbi “trafikimin e armëve dhe municioneve” përfshin sanksione të burgimit nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet për ata që shpallehin fajtorë, ndërsa neni 279 mbi “Prodhimin dhe armëmbajtjen pa leje të armëve të vogla dhe të lehta” ka dënime që variojnë nga gjoba deri në pesë vjet burgim.<sup>310</sup> Nëse një armë që është trafikuar ka shkaktuar pasoja fatale, atëherë kontrabandisti do të dënohej minimalisht me pesë vjet burgim për përfshirje në trafikim armësh. Nëse do të mund të provohej se trafikuesi kishte lidhje me krimin e organizuar, atëherë dënimi do të ishte në shkallën 15 deri në 25 vjet burgim. Tashmë është e mundur që të jepen denime të perjetshme për trafikim armësh.<sup>311</sup> Në të vërtetë, nëse për shkak të markimit të dobët të armëve ose sfidave të ndarjes së informacionit dhe gjurmimit efektiv të bazuar në zbulim, do të ishte e vështirë të parashikohej disponueshmëria e provave që mund të atribuoheshin impakteve specifike ndaj armëve specifike ose të provoheshin lidhjet midis grupeve të caktuara. Kështu, vendosja e këtyre dënimeve më të rënda është e pamundur.

Bahiti argumentoi se prezantimi i neneve mbi trafikimin dhe armëmbajtjen pa leje në Kodin Penal ishte rezultat i presionit ndërkombëtar.<sup>312</sup> Kjo është një pikëpamje me të cilën duken të bien dakort edhe një numër analistësh shqiptarë, pasi ata argumentojnë se autoritetet shqiptare kanë hartuar dhe janë përpjekur të zbatojnë një sërë strategjish për të trajtuar trafikimin gjatë viteve të fundit, kryesisht për shkak të pritshmërive ndërkombëtare.<sup>313</sup> Për shëmbull, në vitin 2001, Qeveria Shqiptare miratoi një Strategji

<sup>307</sup> Intervista, zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 27 Prill 2005; zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 20 Prill 2005; zyrtar ndërkombëtar, 19 Prill 2005.

<sup>308</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 20 prill 2005.

<sup>309</sup> Nenet 28, 233 dhe 234 të Ligjit No. 7895, ‘Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë’, 27 janar 1995, përcaktojnë bandat e armatosura dhe organizatat kriminale të bazuara në llojin e bashkëpunimit të ndërmarrë, numrin e pjesëmarrësve, nivelin e organizimit, veprat penale që duhet të konsiderohen dhe gjithashtu lejon dënime nga pesë vite burgim deri në burgim të perjetshëm.

<sup>310</sup> Raporti i qeverisë shqiptare mbi zbatimin e rezolutës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara 1373 mbi luftën kundër terrorizmit (I azhurnuar).

<sup>311</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 20 prill 2005.

<sup>312</sup> Ibid.

<sup>313</sup> Op cit Bumçi, Ymeri dhe Dakli, p. 26.

Kombëtare Antitrafikim, e cila përmbante një plan veprimi katër vjeçar dhe krijimin e një komiteti drejtues ndërministror. Megjithatë, Strategjia i referohej qartë trafikimit të personave dhe donatorët e huaj identifikuan një numër dobësish, duke cuar në një strategji të përmirësuar që u miratua në vitin 2003.<sup>314</sup> Studiuesit ndërkombëtarë theksojnë se legjislacioni i mirë shqiptar antitrafikim për sa i përket trafikimit të qënieve njerëzore ka ende nevojë të zbatohet në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare.<sup>315</sup>

Sipas drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Shqiptare, Bajram Ibraj, janë ndërmarrë një numër iniciativash kombëtare në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë në lidhje me trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta në Shqipëri gjatë viteve të fundit, duke përfshirë:

- Zhvillimin e një ‘Strategjie Kombëtare kundër Trafikimit të paligjshëm dhe Krimit të Organizuar’;
- Krijimin e një Task Force për zhvillimin e bashkëpunimit midis policisë dhe shërbimeve doganore për luftën kundër trafikimit;
- ‘Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armeve të Vogla dhe të Lehta’;
- Krijimin në 2001 të strukturave speciale për antitrafikimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe në 12 qarqet e Shqipërisë;
- Krijimin e një Drejtorie kundër Krimit të Organizuar dhe për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.<sup>316</sup>

Për më tepër, dispozitat e mëtejshme në lidhje me përpjekjet antitrafikim u prezantuan në vitin 2004. Për shëmbull, amendimet në ligjin No. 7905, ‘Kodi i Procedurës Penale’ (21 mars 1995) u miratuan në maj të vitit 2004. Këto mundësojnë përdorimin e agjentëve të fshehte, pajisje survejimi, operacione goditëse dhe një sërë mekanizmesh të tjerë për zbulimin e provave që më parë kishin qënë të padepërtueshme.<sup>317</sup> Një ndryshim tjetër i rëndësishëm ligjor ishte amendimi i nenit 12 të Ligjit No. 8553, ‘Mbi Policinë e Shtetit’ (25 nëntor 1999), i cili mundësoi një numër ndryshimesh në fushat që kishin të bënin me rregullimet institucionale për luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit, mbrojtjes së dëshmitarëve dhe menaxhimit të integruar të kufirit. Pas këtij amendimi, Departamenti i Ministrisë së atëhershme të Rendit për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Bashkëpunimit me Drejtësinë, i cili ishte krijuar si nëndrejtori në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Kriminale në vitin 2001, u ingranua në një drejtori më vete – Drejtoria e Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve - në tetor 2004.<sup>318</sup> Për më tepër, në vitin 2004 u krijua Prokuroria për Krimet e Rënda.

### 4.3 Asgjësimi i armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve

Nga perspektiva e kontrollit të fluksit të armëve të vogla dhe të lehta drejt end-userave e padëshirueshëm, metoda optimale për zgjidhjen e çështjes së stoqeve të tepërta të armëve të vogla dhe të lehta, veçanërisht e armëve më të përdorura, të cilat zakonisht nuk janë objekte të zgjedhjes për end-user-at e ligjshëm, është shkatërrimi (më tepër sesa shitja, dhurimi ose ri-përdorimi). Bazat ligjore për asgjësimin dhe shkatërrimin e armëve të vogla dhe të lehta mbështeten mbi vendimet e mëposhtme qeveritare dhe urdhrat ministrore:

<sup>314</sup> Ibid, p. 27.

<sup>315</sup> ‘OSCE’s Konrad kritikon deshtimin për të zbatuar ligjet mbi trafikimin’, Cështje të Krimit dhe Korrupsionit në Shqipëri, 15–21 janar 2005. Burimi: Shekulli, 21 janar 2005.

<sup>316</sup> Bajram Ibraj, Drejtori i përgjithshëm i Policisë, ‘Iniciativat shqiptare mbi luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta’, prezantim në workshopin Trajtimi i trafikimit të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta në Europën Juglindore, Tirana, Shqipëri, 14–15 dhjetor 2004. Njoftim për shtyp në web-site e Ministrisë së Rendit, 14 dhjetor 2004, <<http://www.mpo.gov.al/english/mrp-ENGLISH.htm>>, 7 prill 2005.

<sup>317</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 20 prill 2005.

<sup>318</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 20 prill 2005.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 617, 'Mbi caktimin e përgjegjësisë Ministrisë së Mbrojtjes për shkatërrimin e armëve, municioneve dhe pajisjeve ushtarake të tepërta, 4 dhjetor 2002;
- Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes Nr. 281, 'Mbi trajtimin e pajisjeve të tepërta dhe te dala jashte organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë', 17 qershor 2003;
- Urdhri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë Nr. 22, 'Mbi zbatimin e procesit të çmilitarizimit dhe procedurave për shkatërrimin e pajisjeve ushtarake të tepërta (tanke, njësi artilerie etj)', 12 janar 2004.<sup>319</sup>

Të marra së bashku, ato përmbledhin kushtet sipas të cilave duhet të trajtohen armatimet dhe municionet e tepërta. Në përgjithësi, ato kërkojnë rikuperimin e hekurishteve skrap nga pajisjet e çmilitarizuara, të cilat më pas mund të shiten. Armët e vogla dhe e lehta si dhe municionet e grumbulluara përfshihen në dërgesat e pajisjeve të tepërta të dërguara në vendet ku do të shkatërrohen.

#### 4.4 Amnistia e AVL dhe legjislacioni e struktura e grumbullimit

Ligji që mbulon amnistinë mbi armëmbajtjen pa leje dhe grumbullimin e armëve, ka pushuar së paturi efekt në fund të muajit maj 2005, duke e ndaluar kështu grumbullimin e vazhdueshëm të armëve nga publiku. Evoluimi i kuadrit legjislativ në lidhje me amnistinë dhe grumbullimin e armëve dhe statusi i legjislacionit aktual trajtohet me vete në seksionin 6.

#### 4.5 Baza ligjore për kontrollin e KRSF-ve

Ligjet kryesore që rregullojnë punën e industrisë së sigurimit janë:

- Ligji Nr. 8770, (19 prill 2001) 'Mbi Shërbimin e Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike';
- Shtesa në ligjin që ka kaluar në shtator të vitit 2002 (Ligji No 8936, 'Mbi një shtesë në Ligjin Nr. 8770', Fletorja Zyrtare No. 23 Maj 2001) dhe shkurt 2005 (Ligji Nr. 9343, 'Për disa amendime në Ligjin No. 8770').

Për sa i përket mbajtjes dhe përdorimit të armëve të vogla dhe të lehta nga KRSF-të, rojeve të sigurimit u lejohej të mbanin një Kallashnikov dhe pistoletë, ndërsa drejtuesve teknikë dhe truprojave u lejohej të mbanin armë të kamufluara. Të gjitha armët e përdorura nga KRSF-të duhet të furnizoheshin dhe regjistroheshin te punonjësi dhe rojat individuale nga policia, të cilët përcaktonin gjithashtu tipet dhe sasitë e armëve dhe municionit të kërkuar nga KRSF-të. Drejtuesve teknikë dhe punonjësve nuk u lejohej të përdornin armët e tyre të zjarrit ose të blinin armë zjarri nga kontrabandistë privatë për sigurinë e punës së tyre. Megjithatë, KRSF-të mund të blejnë direkt tek furnizuesit mjetet sprucuese dhe armët që mund të shkaktojnë paralizë të përkohshme, nëse ato kanë leje të posacme të lëshuara nga policia dhe më pas të informojnë policinë mbi marrjen e këtyre objekteve.

Ligji mbi KRSF-të nuk mbulon metodat e magazinimit, por KRSF-të duhet të zbatojnë të njëjtat ligje dhe norma të përgjithshme që rregullojnë përdorimin dhe magazinimin e armëve të vogla dhe të lehta të mbajtura nga policia e shtetit dhe forcat ushtarake. Disa nga rregulloret dhe normat janë grumbulluar në një manual të përgatitur për KRSF-të nga Policia e Shtetit, e cila deklaron se "armët sigurohen në armatura dhe kasaforta".

Kuadri aktual ligjor kërkon që KRSF-të të licensohen nga Ministria e Rendit, me qëllim

<sup>319</sup> Raport mbi zbatimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Masat për Parandalimin, luftimin dhe eliminimin e tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe armatimeve të lehta në të gjitha aspektet e saj. Të dhëna të dorëzuara nga Shqipëria në Departamentin e Kombeve të Bashkuara për Cështje të Çarmatimit në vitin 2004. <<http://disarmament.un.org:8080/cab/nationalreports/2003/Albania.pdf>> ('Albania UN PoA Report 2004').

që të jenë funksionale. Licensat e kompanive jepen për një perioudhë prej tre vjetësh<sup>320</sup> dhe tipi i licensës së dhënë varet nga detyrat specifike që firmat aplikante aplikojnë për ta zbatuar. Ato firma të cilat dëshirojnë të sigurojnë mbrojtje për ndërtesat private dhe publike duhet të kërkojnë dhe sigurojnë një 'licensë të kategorisë A'. Licensat e 'kategorisë B' i lejojnë firmave të sigurojnë sigurimin fizik të personave ndërsa licensat e 'kategorisë C' mbulojnë ruajtjen e vlerave dhe objekteve të çmuara.<sup>321</sup> Ministria është përgjegjëse për të përcaktuar nëse kerkohen aplikime për të mbajtur armë zjarri dhe për nxjerrjen e licensave për firmat në lidhje me armët e zjarrit.<sup>322</sup>

Leja për tregti kushtëzohet nga statusi i drejtuesit teknik të firmës dhe punonjësve të tjerë, të gjithë prej tyre duhet të jenë të regjistruar pranë policisë së shtetit.<sup>323</sup> Drejtuesit teknikë dhe punonjësit duhet të jenë shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri,<sup>324</sup> dhe çdo individ që ka qënë i dënuar më parë përjashtohet nga ky tip punësimi.<sup>325</sup> Për më tepër, punonjësit e policisë nuk mund të kenë një punë të dytë si oficerë sigurimi, ndërsa punonjësit e policisë të shkarkuar nga postet e tyre për korrupsion nuk lejohen të punojnë për KRSF-të.

Me qëllim mbrojtjen e industrisë lokale nga konkurrenca e huaj, ligji specifikon që KRSF-të ndërkombëtarë mund të hyjnë në tregun shqiptar vetëm në bashkëpunim me një firmë shqiptare ose individë shqiptarë.<sup>326</sup> Një kufizim i dytë vendos kufij striktë në numrin e stafit që cdo kompani mund të punësojë. Kjo është unike në rajonin e Europës Juglindore dhe ka synim të mbrojtë pozicionin dominues të sektorit të sigurisë publike përkundrejt konkurrencës private – KRSF-të mund të punësojnë jo më shumë se pesë për qind të numrit total të policëve në rreth në të cilin ata janë të licensuar të operojnë.<sup>327</sup> Kërkesat e tjera ligjore përfshijnë një dispozitë që rojat private të sigurimit marrin minimalisht 15 ditë trajnim (i cili duhet të sigurohet nga drejtuesi teknik i kompanisë) para se të kalojnë një provim të administruar nga policia e shtetit. Punonjësve u kërkohet gjithashtu që çdo vit<sup>328</sup> të ndërmarrin kurse azhurnimi pesë ditore.

Ligjet e mësipërme parashikojnë sanksionet e mëposhtme ligjore: kompanitë mund të gjobiten nga €800 deri në €1800 për shkelje ligjore dhe drejtuesit teknikë mund të gjobiten diku midis €150 dhe €400 për shkelje.

## 4.6 Legjislacioni i mbajtjes së armëve nga civilët

Mbajtja e armëve nga civilët rregullohet kryesisht nga ligji Nr. 7566, "Mbi armët" (i datës 25 maj 1992). Ligji Nr. 7566, "Mbi Armët", deklaron se civilët mund të mbajnë armë të klasifikuara si armë gjahu,<sup>329</sup> edhe armë sportive që mbeten në pronësi të shtetit. Megjithatë, ka një sërë përjashtimesh për këtë rregull. Për shëmbull, individët e mëposhtëm kanë të drejtë të mbajnë një armë zjarri, e cila mund të lëshohet për ta vetëm nga Ministria e Brendshme:

<sup>320</sup> Neni 3, Paragrafi 2, Ligji No. 9343.

<sup>321</sup> Nenet 4 dhe 5 të Ligjit No. 8770, 'Mbi ruajtjen e sigurisë fizike', 19 prill 2001, shpjegojnë kërkesat e licensimit, duke përfshirë kufizimet gjeografike të vëna mbi mbajtësit e licensës të kategorisë A, pasi ata mund të operojnë vetëm brenda distriktit për të cilin ata mbajnë licensë. Kategoria e mbajtjes së KRSF category A+B, B dhe licensave C janë të autorizuar të operojnë në të gjithë vëndin.

<sup>322</sup> Neni 2, Paragrafi 3, Ligji No. 8770.

<sup>323</sup> Neni 7 of Ligjit No. 8770 specifikon se KRSF-te duhet të regjistrohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Neni 14, Paragrafi 2 deklaron se drejtori teknik i KRSF duhet të regjistrohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe neni 15, paragrafi 2 specifikon se punonjësit e KRSF duhet të regjistrohen pranë Drejtorisë së Policisë në nivel rrethi.

<sup>324</sup> Neni 2, Paragrafi 2, Ligji No. 8770.

<sup>325</sup> Neni 14, Paragrafi 1ç i Ligjit No. 8770 mbulon drejtorin teknik dhe neni 15, Paragrafi 1c mbulon punonjësit e PSC.

<sup>326</sup> Neni 2, Paragrafi 1, Ligji No. 8770.

<sup>327</sup> Neni 11, Paragrafi 2, Ligji No. 8770, 'Mbi shvrbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike', 19 prill 2001.

<sup>328</sup> Neni 16 shpjegon kërkesat e trajnimit. Trajnimi i siguruar nga drejtuesi teknik duhet të përkrahë legjislacionin dhe rregulloret, përgjegjësitë dhe detyrat e KRSF sipas ligjit, përdorimin e armëve, përdorimin e pajisjeve të telekomunikacionit, ndihmën e parë bazë dhe si të shuhet një zjarr. Drejtuesit teknikë priten të jenë diplomuar nga akademi ushtarake ose policore dhe të kenë përvojë ushtarake ose policore nga pesë deri në dhjetë vjet.

<sup>329</sup> Nga Dekreti No. 195, "Mbi promulgimin e Ligjit No. 7566 'Mbi armët'", 25 shtator 1992.

- Deputetët
- Anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe njerëz të tjerë të barazvlefshëm me ta
- Kryetarët e partive politike
- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
- Shefi i Zyrës së Hetimit të Përgjithshëm dhe zëvendësat e tyre
- Drejtuesit e disa njësive administrative të njësive administrative të qeverisë vendore
- Magjistratët
- Punonjesit e permbarimit gjyqesor
- Prokurorë
- Hetues shtetërorë
- Shoferë të deputetëve, kryetarë të partive politike, Krerët e Gjykatës Kushtetuese dhe Zyra e Hetimit të Përgjithshëm.<sup>330</sup>

Për më tepër, Ministria e Brendshme mund të japë leje dhe të pajisë rojat private të ruajtjes dhe sigurisë fizike me armë zjarri dhe të trajnojë stafin për trenat e pasagjerëve dhe ngarkesave.<sup>331</sup> Dy vendime të Këshillit të Ministrave të kaluara në përputhje me Ligjin Nr. 8388 'Mbi grumbullimin e armëve të vogla dhe të lehta' (5 gusht 1998), zgjeruan numrin e kategorive për mbajtje me leje nga njerëzit që jetojnë në zonat kufitare dhe biznesmenët me kapital mbi 50 milion Leke (rreth \$500,000).<sup>332</sup> Racionalja prapa lejjimit të atyre që jetojnë në zona kufitare të mbajnë armë zjarri me lej, sipas raportit, ishte se ata priteshin të vepronin si 'roje kufitare civile' pas rënies së shtetit në vitin 1997.<sup>333</sup> Gjithashtu, në kontrast me kategoritë e autorizuara të mbanin një armë zjarri të listuar si më sipër, dy kategoritë e specifikuar në ligjin për grumbullimin e armëve të vogla dhe të lehta të vitit 1998 u lejuan të regjistronin armë që nuk u ishin dhënë atyre "në mënyrë të drejtpërdrejtë" nga Ministria e atëhershme e Rendit, por që kishte shumë të ngjarë të ishin grabitur në vitin 1997. Kjo dispozitë nuk u implementua në ligjin e 2003- shiti "Mbi grumbullimin e armëve të vogla dhe armatimeve të lehta" dhe ne u informuam se biznesmenët nuk mund të regjistrojnë më armë zjarri për vetëmbrojtje.<sup>334</sup>

Megjithatë, një kryeinspektor nga Fieri deklaroi se biznesmenët mundën ende të aplikojnë për një licensë për pistoletë. Gjithsesi, është e qartë se atyre biznesmenëve që regjistruan armët në 1998 nuk iu kërkua të kthenin armët dhe licensat e tyre. Megjithëse u vlerësuan aplikimet e atyre që kërkonin të regjistronin armë në përputhje me ligjin e grumbullimit të armëve të vogla dhe të lehta të vitit 1998, ne nuk na u raportua për ndonjë rast refuzimi. Kështu, një nga tiparet më interesante të punes në terren të kryer në rajonet e Shqipërisë është se ka një sërë opinionesh se kush ka të drejtë ligjore të mbajë një armë. Për shëmbull, sipas drejtorit të policisë rajonale të Kukësit, Ylli Tafilli, dy lloje njerëzish kanë të drejtë të regjistrojnë një armë: biznesmenët dhe njerëzit që jetojnë në zona kufitare.<sup>335</sup> Megjithatë, Shkelqim Pepkola, shefi i komisariatit të policisë në Kukës, deklaroi se që prej vitit 1997 kishte qënë e mundur të regjistroheshin vetëm armët e gjahut.<sup>336</sup> Në Kukës, policia deklaroi se ato ishin në procesin e grumbullimit të armëve që ishin regjistruar midis periudhës 2001 dhe 2003, pasi kjo ishte udhëruar nga Ministria e Brendshme.<sup>337</sup> Asnjë i intervistuar tjetër nuk na përmendi këtë urdhër. Kështu, konfuzioni padyshim që lind nga paqartësia nëse ligji i 1998-ës "Mbi grumbullimin e armëve të vogla dhe të lehta", zbatohet akoma apo jo.

<sup>330</sup> Neni 5 i Dekretit No. 195, "Mbi promulgimin e Ligjit No. 7566 'Mbi armët'", 25 shtator 1992.

<sup>331</sup> Neni 7 i Dekretit No. 195, "Mbi promulgimin e Ligjit No. 7566 'Mbi armët'", 25 shtator 1992. Neni 9 deklaroi se ata duhet të jenë mbi 22 vjeç, të mos jenë të sëmurë mendërisht ose me dëmtime fizike dhe të mos jenë dënuar më parë. Neni 7 gjithashtu deklaroi se Ministria e Brendshme mund të japë leje dhe të pajisë me armë zjarri studion e filmit "Albafilm", publikun transmetues, trupën teatrore, muzeumet kombëtare dhe lokale, megjithëse neni 8 deklaroi se këto armë zjarri duhet të jenë 'jo funksionale'.

<sup>332</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 53, "Mbi përcaktimin e zonave kufitare, llojet e armëve, numrin e municionit, kriteret për dhënien e licensave për armët me leje dhe tarifën përkatëse", 4 shkurt 1999; Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 56, "Mbi dhënien e licensave për armët me leje për presidentët dhe ortakët e kompanive tregtare", 4 shkurt 1999.

<sup>333</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 15 prill 2005.

<sup>334</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.

<sup>335</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 27 prill 2005.

<sup>336</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 27 prill 2005.

<sup>337</sup> Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 27 prill 2005; zyrtari i Ministrisë së Rendit, 27 prill 2005.

Një projektligj i ri do t'i lejonte biznesmenët me 50,000 Lek, ose pronarët e më shumë se pesëdhjet kafshëve të aplikonin për një armë. Kjo pason një rekomandim nga departamenti i policisë, meqë besohet se këta individë tashmë kanë armë.<sup>338</sup>

Armët e policisë rregullohen sipas ligjit për Policinë e Shtetit.<sup>339</sup>

Sistemi aktual për lëshimin e licensave të armëve për civilët është që komuniteti, shefat e policisë kriminale dhe të rendit publik të zonës takohen në një komitet në rajonin e policisë lokale për të dhënë një vlerësim për aplikimin. Sipas ligjit, vendimet mbi dhënien e licensave duhet të merren brenda 30 ditësh.<sup>340</sup> Ligjet si të 1992 dhe të 1998 kërkojnë, midis të tjerash, që të merret një deklaratë nga punonjësi i policisë lokale që ju nuk jeni në konflikt me fqinjët tuaj kur aplikoni për licensë për të marrë armë zjarri.<sup>341</sup> Procesi aktual i regjistrimit nuk është i mirëpublikuar, megjithëse është shfaqur një herë në Internet.<sup>342</sup>

338 Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.

339 Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.

340 Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.

341 Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.

342 Intervista, zyrtari i Ministrisë së Rendit, 25 prill 2005.